



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:230679

Datë: 19.01.2024

Numri i dokumentit: 05212720

PML.nr.682/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar, Mejreme Memaj e Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në lëndën penale të dënuarit H. M., nga fshati Gj., komuna e S., për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, parashikuar me nenin 321 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë mbrojtësit të dënuarit avokatit Gent Gjini, paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë P.nr.397/2022 datë 21.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16 janar 2024, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

Hedhet si e pasafatshme kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit H. M., e paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë P.nr.397/2022 datë 21.03.2023.

#### A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, me aktgjykimin P.nr.397/2022 e datës 21.03.2023, të dënuarin H. M., për veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, parashikuar me nenin 321 par.1 të KPRK, e ka gjykuar me tre (3) muaj burgim.

Aktgjykimi i lartcekur është bërë i plotfuqishëm më datë 09.06.2023.

Kundër aktgjykimit të lartcekur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Gent Gjini, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptohet një dënim me i butë me kusht apo me gjobë apo çështjen ta kthej në rigjykim.

Ndaj kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë është përgjigjur Prokurori i Shtetit me parashtresën me shkrim KMLP.II.nr.400/2023 e datës 22.12.2023, me propozim që kërkesa të hedhet si e pasafatshme.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP, vlerësoj pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa është e pasafatshme.

Sipas dispozitës së nenit 433 par.1 të KPP kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqes kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, kurse sipas par.2 të të njëjtit nen kryeprokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat e paraparë me nenin 424 par.1 fjalë e fundit e këtij kodi mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajve nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Nëse kundër vendimit të gjykatës themelore nuk paraqitet ankesë, afati rrjedh nga dita kur vendimi merr formë të prerë.

Nga shkresat e lëndës del se ndaj aktgjykimit të shkallës së parë nuk është ushtruar ankesë, kurse aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm më datë 09.06.2023, gjë që vërtetohet nga vula e plotfuqishmërisë, kurs kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur më datë 12.12.2023 që vërtetohet nga shkresa e zyrës së pranimit të gjykatës së shkallës së parë.

Duke llogaritur afatin tre mujor, që në rastin konkret nis nga dita kur vendimi ka marr formë të prerë, rezulton se afati i fundit për ushtrimin e kërkesës ka qenë 9 shtatori i vitit 2023, kurse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pranuar në gjykatën e shkallës së parë me 12.12.2023, prandaj kjo gjykatë vlerëson se kërkesa është paraqitur pas afatit ligjor dhe e hodhi atë konform dispozitës së nenit 435 par.2 të KPP.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**  
PML.nr.682/2023, më 16 janar 2024

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Rasim Rasimi